



THE SCHOOL DISTRICT OF PHILADELPHIA

8 Nëntor, 2019

Të dashur prindër të shkollës Northeast:

Drejtoria Arsimore e Filadelfias po punon çdo ditë për të siguruar që nxënësit dhe personeli ynë të kenë një mjedis të sigurtë, të shëndetshëm, në të cilin të mësojnë dhe të punojnë. Në emër të Drejtorisë Arsimore, unë po ju shkruaj për të ndarë informacione me ju në lidhje me pllakat e dëmtuara të dyshemesë në dhomën 21-A. Kjo dhomë përdoret si zyrë për një anëtar të shkollës sonë. Të dhënat tona konfirmojnë se këto pllaka të dëmtuara përmbajnë asbest.

Menjëherë, pas marrjes së njoftimit, Koordinatori i Zonës së Facilitetit vizitoi shkollën për të vlerësuar kushtet dhe për të vlerësuar shkallën e dëmit. Si rezultat i vizitës së FAC, dhoma 21-A u mbyll menjëherë. Më 14 tetor 2019, një inspektor i licencuar i mjedisit, i palës së tretë, përfundoi një vlerësim të dëmit dhe hartoi një plan pune për të hequr pllakat e dyshemesë. Inspektori gjithashtu vëzhgoi zona të tjera të ndërtesës në 16 Tetor, për të dokumentuar dëmtimin e materialeve që përmbajnë asbest. Rezultatet e inspektimit identifikuan gjashtë zona me pllaka dyshemeje të dëmtuara, dhe pajisje tubi që përmbajnë asbest.

Bazuar në dëmin e identifikuar, Drejtoria Arsimore nuk beson se kemi një dëmtim të menjëhershëm për nxënësit dhe personelin në godinën e shkollës; megjithatë, ne kemi filluar të punojmë me Drejtorin Z. Crowder për të hartuar një orar për të riparuar ose hequr materialet e dëmtuara. Ky plan do të ndahet me Drejtorinë e Federates së Mjedisit të Mësuesve. Duke pasur parasysh numrin e madh të nxënësve dhe numrin e aktiviteteve dhe programeve në ndërtesë, Drejtoria do të planifikojë ulje të aktiviteteve gjatë fundjavave në festat e Falënderimit dhe Pushimet Dimërore kur nxënësit nuk janë në ndërtesë. Puna do të fillojë gjatë fundjavës së Ditës së Veteranit për të riparuar pllakat e dëmtuara të dyshemesë në korridoret dhe dhomën 21-A.

Kopjet e raportit të inspektimit janë në dispozicion në dosjen AHERA në zyrën kryesore dhe gjithashtu do të postohen në faqen e internetit të NEHS dhe Drejtorisë Arsimore (www.philasd.org).

Siguria e nxënësve dhe e personelit mbetet përparësia jonë më e lartë. Ne e vlerësojmë mirëkuptimin, durimin dhe fleksibilitetin tuaj. Ju mund të kontaktoni Zyrën e Menaxhimit të Mjedisit dhe Shërbimeve në 215-400-4730 me pyetjet, reagimet tuaja ose shqetësimet e tjera.

Sinqerisht,

Danielle Floyd
Chief Operation Officer